



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHË**

*10 qershor 2013, Prizren*

**KOMUNIKATË  
Kryetari i Komunës përkrah disa vendime për rini**

Në kuadër të projektit “Rritja e pjesëmarrja përmes medieve sociale”, EC Ma Ndryshe ka nisur monitorimin e vendimeve të qeverisë komunale në sektorin e rinisë. Prej muajit janar deri në maj të këtij viti janë marrë disa konkluzione nga kryetari i komunës për realizimin e projekteve rinore, kulturore dhe sportive.

Më 15 janar, kryetari i Komunës, miratoi propozimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mbështetje financiare të organizimit të ceremonisë për shpalljen e sportistëve më të mirë dhe shpalljen e më të dalluarve nga lëmi i kulturës për vitin 2012.

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2013 me drejtoritë komunale miratoi propozimin e DKRS-së për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e 7 (shtatë) projekteve kapitale, që kanë të bëjnë me infrastrukturën kulturore-sportive dhe organizimin e festivaleve tradicionale, si:

1. Hartimin e projekteve,
2. Rregullimin e stadiumit të qytetit,
3. Ndërtimin e terrenit sportive në Sërbicë të Poshtme,
4. Ndërtimin e Qendrës kulturore – sportive në Lubizhdë të Prizrenit,
5. Ndërtimin e Qendrës kulturore – sportive në Lubizhdë të Hasit,
6. Ndërtimin e sallës sportive në Qendrën sportive në Prizren (faza e fundit), dhe
7. Organizimin e festivaleve tradicionale (“Zambaku i Prizrenit”, “Fluturat”, “Rock Live” ...)

Në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2013 të Kryetarit të Komunës me drejtoritë komunale, u miratua propozimi i DKRS-së për lejimin e shpalljes së tenderit për vlerësimin dhe hartimin e projektit për ndërtimin e kulmit të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur.

Pas propozimit të DKRS-së, bazuar në kërkesën e Shoqatës së pedagogëve të kulturës fizike të Prizrenit, për përkrahje financiare për pjesëmarrje në Kampionatin Botëror të Sportit Shkollor në Basketboll që mbahet në Qipro me datën 28 mars 2013 e në të cilin eveniment do të marrë pjesë edhe ekipi i basketbollit i ShM “Gjon Buzuku” nga Prizreni, kryetari i Komunës më 12 mars 2013 lejoi për këtë qëllim 3,200 euro.

Kryetari i Komunës me 2 prill 2013 ka miratuar kërkesën e Shoqatës për Përparimin e Medieve “Shadërvani” për mbështetje financiare të projektit “Rinia- Vështirësitë dhe e ardhmja e tyre”, dhe morri vendim që për këtë qëllim të ndahen 1,000 €.

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2013 miratoi propozimin e DKRS-së për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e disa projekteve kapitale. Shpallja e tenderit bëhet për këto projekte:

1. Renovimin dhe rregullimin e kalimit dhe oborrit të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur,
2. Renovimin dhe rregullimin e oborrit të Qendrës Kulturore-Sportive në fshatin Romajë, dhe
3. Renovimin dhe rregullimin e oborrit të Qendrës Kulturore-Sportive në fshatin Gërinqar.

Pas propozimit të DKRS-së për shënimin e 31 Majit – Ditës Ndërkombëtare kundër pirjes së duhanit, kryetari i Komunës, më 23 prill 2013, miratoi propozimin, duke ndarë 1,500 € për këtë qëllim. Ky projekt do të zbatohet nga Këshilli Rinor, në bashkëpunim me organizata të tjera rinore, Këshilli i nxënësve dhe do të monitorohet nga DKRS.

Për nder të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, kryetari i Komunës, më 15 maj 2013, miratoi propozimin e DKRS-së për mbështetje të:

1. Turneut tradicional përkujtimor i futbollit kushtuar dëshmorit Sinan Thaqi, që mbahet në Prill në fshatin Zojz, përkrahet financiarisht me 500 €,
2. Turneut tradicional përkujtimor në futboll kushtuar dëshmorit Përparim Thaqi, që mbahet në prill në fshatin Landovicë, përkrahet financiarisht me 300 €,
3. Turneut të garës komunale të peshkatarisë sportive “Prizreni 2013”, që mbahet në Prizren dhe organizohet nga ShP “Drini i Bardhë”, përkrahet financiarisht me 300 €,
4. Turneut të futbollit kushtuar “Rinisë së Prizrenit” që mbahet në Prill 2013 në Prizren dhe organizohet nga Qendra Rinore, përkrahet financiarisht me 300 €,
5. Turneut me biçikleta i quajtur “Biçikliada e të rinjve 2013”, përkrahet financiarisht me 500€,
6. Turneut të futbollit për veteran që mbahet në maj 2013 dhe që organizohet nga KO i këtij turneu, përkrahet financiarisht me 300 €,
7. Turneut përkujtimor i futbollit “Pal Paluca”, përkrahet financiarisht me 300 €,
8. Turneut tradicional i shahut “Faleminderit Kukës 2013” që organizohet në muajin maj 2013 në Prizren, përkrahet financiarisht me 500 €. Ky turne organizohet në bashkëpunim me revistën “Fidani”,
9. Turneut të futbollit në Pllanjan përkrahet financiarisht me 300 €,
10. Turneut të futbollit kushtuar sportistit Ferid Murselit, që mbahet në maj 2013 në fshatin Novo Selan, përkrahet financiarisht me 300 €,

11. Turneut tradicional përkujtimor “Zenun Qoqaj” që mbahet në qershor 2013 në fshatin Gjonaj, përkrahet financiarisht me 300 €.

12. Turneut tradicional të futbollit “Lubizhda 2013” nga fshati Lubizhdë që mbahet në qershor 2013 dhe që i kushtohet jetës dhe veprës së Komandant Drinit, përkrahet financiarisht me 300 €, dhe

13. Turneut tradicional të futbollit “Reçani 2013” nga fshati Reçan që mbahet në korrik 2013 dhe që i kushtohet të rënëve të trevës së Zhupës, e që organizohet nga OJQ “Kosmopolit”, përkrahet financiarisht me 300 €.

Gjithsejtë shuma e përgjithshme e mjeteve që lejohen në emër të përkrahjes financiare për aktivitetet e lartcekura është 4500 €.

Me respekt,

Elmedina Baxhaku, asistente e projektit  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

*Projekti “Rritja e Pjesëmarrjes përmes Mediave Sociale”, përkrahet financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Projekti SMILE i financuar nga Democratic Governance Thematic Trust Fund (DGTTF).*



*Empowered lives.  
Resilient nations.*